

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ELVIN HOXHA
Çertifikatë Nr.206/Janar 2015/Person Fizik/Nipt L42109004H

Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane E-mail: elvinth@hotmail.com Mob: +355682029920

Nr.265 Dosje
Nr. 73 Prot.

Tiranë më datë 8/1 /2018

URDHËR
(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Per Dijeni : Debitorit Personi Fizik Krenar Avdulla, I regjistruar me Nr.Nipt L43724802T
Kreditorit Autoriteti I Mediave Audiovizive (AMA)

Unë Elvin Hoxha me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.1757 datë 03.12.2015, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i lëshuar për Titullin Ekzekutiv Gjobë Nr.17 datë 24.06.2015, të Grupit të Inspektimit të AMA-s të vendosur ndaj **Personi Fizik Krenar Avdulla, I regjistruar me Nr.Nipt L43724802T, i autorizuar për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Saranda Kabëll"** lënë në fuqi masa e gjobës me Vendimin Nr.87 datë 26.10.2015 të AMA-s, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, me kërkesën e kreditorit **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)** duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr265, Datë 20.12.2017.

Në kushtet kur për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, nuk është përmbushur detyrimi në mënyrë vullnetare, nga ana e Përmbaruesit Gjyqësor Privat duhet të kryhet vendosja e masës së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e palës debitore **Personi Fizik Krenar Avdulla, I regjistruar me Nr.Nipt L43724802T, "Tv Saranda Kabëll"**, në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

URDHËROJ

1-Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e palës **Personi Fizik Krenar Avdulla, I regjistruar me Nr.Nipt L43724802T, "Tv Saranda Kabëll"**si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat në regjistrin tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga Përmbaruesi Gjyqësor Elvin Hoxha.

- **Personi Fizik Krenar Avdulla, I regjistruar me Nr.Nipt L43724802T, i autorizuar për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Saranda Kabëll", me adresë Lagjja nr.4, Rruga Idriz Alidhima, Godina 43, kati i pare ,Sarandë**

- Për veprimet apo mos veprimet tuaja duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallëzimit penal.
- Ky urdher mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 (pese) diteve.

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT
ELVIN HOXHA

